LIGJ
Nr. 9794, datë 23.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998 "PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT", TË NDRYSHUAR

(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 8.6.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në nenin 7 paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

Neni 2

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.".

b) Fjalia e parë e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

"Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.".

Neni 3

Në nenin 15 dy fjalitë e para ndryshohen si më poshtë:

"Shkeljet e neneve 4, 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 50 000 deri në 2 000 000 lekë. Shkeljet e neneve 9, 10 e 11 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 50 000 deri në 500 000 lekë. Shkeljet e neneve 12 e 14 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 500 000 deri në 5 000 000 lekë.".

Neni 4

Pas nenit 15 shtohet neni 15/a me këtë përmbajtje:

(Shfuqizuar neni 15/a me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 8.6.2011)

Neni 5

Çdo dispozitë ligjore dhe nënligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 5449, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi